

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“METOQ AGROVOLTAIK”-SHPK,**

Sot më datë, 1 Mars 2024, në përputhje me:

- Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”
- Ligjin nr 9723 datë 3.05.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;

Unë **THEMELUESI Alfred ÇARERI**, atësia Thanas, amësia Androniqi, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 13/10/1968, lindur në Tiranë dhe banues në adresën: Rruga: “Brigada e VIII” pall. 19, Hyrja 3, ap. 10, Njësia administrative nr 10-Tiranë, gjëndja civile “martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i dokumentit të identifikimit ID G81013097W, **kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar .**

**TITULLI I**  
**EMRI I SHOQËRISË- REGJIMI JURIDIK - SELIA – KOHËZGJATJA**

**NENI 1**

**Emri i Shoqërisë**

- 1.1 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, është krijuar Shoqëria: “**METOQ AGROVOLTAIK**”-SHPK, në vijim referuar si “Shoqëria”.
- 1.2 Shoqëria ka logon dhe vulën e vet zyrtare.

**NENI 2**

**Regjimi Juridik i Shoqërisë**

- 2.1 “**METOQ AGROVOLTAIK**”-SHPK, është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 2.2 Aktiviteti i saj është i organizuar sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi tregtinë dhe legjislacionin civil në Republikën e Shqipërisë.
- 2.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mund të ndryshojë regjimin e saj juridik, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe dispozitat e Statutit të saj.
- 2.4 Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

**NENI 3**


**Selia**

- 3.1 Shoqëria në përmbushje të aktivitetit të saj e ka selinë në adresën: **Metoq, zona kadastrale: 2677, me numër pasurie: 2/6/21, Metoq-SARANDË.**
- 3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë, filiale dhe / ose zyra përfaqësimi brenda Shqipërisë dhe ose jashtë vendit, ose të krijojë shoqëri të tjera me Partnere apo Aksionarë pjesëmarrës.

**NENI 4**

**Kohëzgjatja**

- 4.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortaku/ët e Shoqërisë mund të vendosin të kufizojnë kohëzgjatjen e aktivitetit me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



## TITULLI II OBJEKTI

### NENI 5

#### Objekti i aktivitetit

5.1 Objekti kryesor i Shoqërise do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në veprimtaritë e mëposhtme:

- Projektim, ndërtim instalim, montim dhe tregëtim i sistemeve të energjisë së rinovueshme, parqeve diellore, (fotovoltaike), parqet e erës (eolike) nëpërmjet turbinave. Prodhim të energjisë elektrike, ndërtim e shfrytëzim të rrjetit elektrik, punime elektrike dhe mekanike.

- Shitjen dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, furnizimin ose tregëtimin e saj në çfarëdo lloj forme, eksportimin ose importimin e saj jashtë Territorit të Republikës së Shqipërisë dhe anasjelltas, si dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike. Shërbim mirëmbajtje, kolaudimi e pastrimi. Matesa induktive dhe elektronik.

- Aplikimi dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo institucionet përgjegjëse të shtetit Shqiptar I të gjitha lejeve, liçensave dhe autorizimeve paraprake/përfundimtare, të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor Shqiptar në fuqi.

- Veprimtari në fushën e bujqësisë, pemtarisë, vreshtarisë, drurëve frutorë. Tregtimi, përpunimi i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale të papërpunuara dhe të përpunuara dhe imputeve dhe makinerive bujqësore të të gjitha llojeve. Veprimtari në sektorin e agroindustrisë. Përpunimi paraprak dhe përfundimtar i produkteve të ndryshme.

Për me tepër Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili nuk është i ndaluar nga ligji në fuqi, që sjell përfitime dhe është në interes të Shoqërisë, si dhe çdo aktivitet tjetër tregtar që lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## TITULLI III

### KAPITALI I SHOQËRISË- TRANSFERIMI I KUOTAVE- ZMADHIMI I KAPITALIT

#### Neni 6

##### Kapitali i Shoqërisë

6.1 Kapitali i shoqërisë është në vlerën **1 000'000 LEK (një milion lekë) me 1 (një) kuotë.**

Kapitali i shoqërisë është paguar plotësisht nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë si më poshtë:

- **Alfred ÇARERI**, i cili zotëron 1 (një) kuotë, që përfaqëson 100 % të kapitalit të shoqërisë.

6.2 Kontributi i ortakut/ortakëve themelues mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta)

6.3 Përgjegjësia e Ortakut Themelues ndaj palëve të treta për detyrimet e marra përsipër nga kompania është e kufizuar sipas pjesëmarrjes së tij në kapitalin e shoqërisë.

#### Neni 7

##### Transferimi i kuotave

7.1 Transferimi i kuotave të shoqërisë ndaj palëve të treta i nënshtrohet së drejtës së parablerjes në favor të ortakëve të tjerë të cilët mund ta ushtrojnë këtë të drejtë sipas kushteve të percaktuara në nenin 7.2 deri në nenin 7.6 më poshtë.

7.2 Në rast se një ortak "Ofruesi" kërkon të shesë dhe/ose të transferojë disa ose të gjitha kuotat e tij, Ortaket e mbetur do të kenë të drejtën e parablerjes në lidhje me kuoten që ofrohen për transferim ("Kuota e ofruar"), sipas kushteve të mëposhtme:

(a) Ofruesi do tu dergojë fillimisht ortakëve të mbetur një njoftim me shkrim i cili përcakton përqindjen e kuotës së ofruar, çmimin dhe kushtet e tjera të transferimit, duke ftuar së pari Ortakët e mbetur të blejnë aksionet e ofruara;

(b) Ortaket e mbetur do të kenë të drejtën të blejnë kuotat e ofruara përpjestimisht dhe sipas kushteve të ofertës, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda një afati prej tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së njoftimit të Ofruesit.

7.3 Në rast se më shumë se një prej Ortakëve të mbetur dëshirojnë të blejnë kuotën e ofruar, secili prej këtyre ortakëve të mbetur do të ketë të drejtën të blejë kuotën e ofruar përpjestimisht sipas përqindjeve që zoterojnë në Shoqëri, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh nga marrja e njoftimit sipas së cilit secili prej tyre dëshiron të blejë kuotën e ofruar.

7.4 Në rast se asnjë nga ortakët e mbetur nuk dëshiron të blejë kuotën e ofruar dhe/ose kanë refuzuar të blejnë kuotën e ofruar dhe/ose nuk janë përgjigjur brenda tridhjetë ditëve nga marrja e këtij njoftimi, Ofruesi do të ketë të drejtën të transferojë Kuotat e ofruara një pale të treta me të njetin çmim që i është ofruar ortakëve të mbetur (sipas kushteve të ofertës fillestare). Nëse ky kusht nuk është përmbushur, Marrëveshja për Shitjen e Kuotave me palet të treta do të jetë e pavlefshme.

7.5 Në rast se ndonjë ose të gjithë ortakët e shoqërisë blen/blejnë kuotat e ofruara sipas kushteve të ofertës, sic përcaktohet më sipër, ky transferim do të kryhet sipas kushteve të ofertës.

7.6 Kushtet e parashikuara më sipër nuk do të zbatohen në rast transferimi të kuotave nga një ortak tek një shoqëri e cila ndodhet nën kontrollin e këtij ortaku ose në rast transferimi nga një ortak tek një pasardhës ose pasardhës i drejtpërdrejtë i tij ose tek bashkëshorti.

7.7 Dispozitat e nenëve 7.1- 7.6, nuk do të zbatohen në rast transferimi të bërë në favor të një ose disa ortakëve të tjerë. Megjithatë, në këtë rast transferimi duhet të komunikohet fillimisht të gjithë ortakëve. Të gjitha njoftimet sipas këtij neni duhet të dergojnë edhe Shoqërisë.

## **Neni 8**

### **Rritja e Kapitalit**

8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të rrisë kapitalin e shoqërisë, në përputhje me kuorumin e përcaktuar në nenin 12 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti.

8.2 Në rast të një rritje të kapitalit, ortakët kanë të drejtë të nënshkrimit të kuotave nëpërmjet kontributit në natyrë ose në të holla, në proporcion me përqindjen që gëzojnë në kapitalin e shoqërisë.

8.3 Nëse ndonjë nga ortakët refuzojë të drejtën nënshkrimit, kapitali mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, ortakët e tjerë mund të ushtrojë të drejtën e tyre për nënshkrimin e kapitalit në proporcion me përqindjen që gëzojnë në kapitalin e shoqërisë.

## **Neni 9**

### **Zvogëlimi i Kapitalit**

9.1 Asambleja e përgjithshme mund të zvogelojë kapitalin e shoqërisë, në përputhje me kuorumin e përcaktuar në nenin 12 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali nuk mund të reduktohet nën vlerën minimale të përcaktuar me ligj.

9.2 Ortakët përballen me uljen e kapitalit të shoqërisë në proporcion me kuotat e zotëruara nga secili prej tyre në kompani.

## **Neni 10**

### **Çertifikata e pjesëmarrjes**

10.1 Secili nga ortakët gëzon të drejtën e një certifikate në lidhje me përqindjen në pjesën që gëzon në kapitalin e shoqërisë. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e mbajtura së bashku nga disa Ortakë dhe shpërndarja e certifikatës për përfaqësuesit e përbashkët e anëtarëve do të konsiderohet e dhënë në interes të të gjithë ortakëve, në përputhje me dispozitat e ligjit.

## TITULLI IV ORGANET E SHOQËRISË

### Neni 11 Organet e Shoqërisë

11.1 Organet e Shoqërisë janë:

- 1) Asambleja e Përgjithshme;
- 2) Administratori / s.

#### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

##### Asambleja e Përgjithshme

11.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë dhe përbëhet nga të gjithë Ortakët e Shoqërisë.

11.2 Çdo Ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblene e Përgjithshme për të shprehur mendimin e tij dhe të votojë në bazë të kuotave që zotëron.

11.3 Ortaku mund të përfaqësohet nga një person tjetër, jo domosdoshmërisht Ortak/e, me anë të një Prokure të Posaçme. Në çdo rast, kjo Prokure e Posaçme mund të jepet vetëm për një Mbledhje të caktuar të Asamblesë së Përgjithshme, dhe do të jetë e vlefshme edhe për mbledhjet pasardhëse me të njëjtin rend dite. Administratorët nuk mund të përfaqësojnë Ortakun në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

11.4 Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet në një vend të ndryshem nga selia e Shoqërisë, në Republikën e Shqipërisë ose jashtë vendit.

11.5 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori, sipas nevojave dhe interesave të Shoqërisë ose nëse kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe nga çdo Ortak që zotëron të paktën 10% (dhjetë për qind) të pjesës së kapitalit. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda javës së fundit të muajit Maj, në mënyrë që të diskutojë, të shqyrtojë dhe të miratojë bilancin vjetor të vitit të kaluar fiskal. Mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme, do të mbahet brenda tre muajve nga dita e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar për të diskutuar planin e biznesit dhe çështje të tjera.

11.6 Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme do të bëhet me letër rekomande me njoftim marrjeje, dhe do të dërgohet në adresat e Ortakëve të shoqërisë të regjistruara në Regjistrin e Ortakëve, ose me postë elektronike në adresat e Ortakëve, ose me poste tek Ortakët së paku 21 (njëzet e një) ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

11.7 Njoftimi duhet të përmbajë informacion mbi çështjet që do të diskutohen në rendin e ditës dhe mbi të cilat do të merret vendim, vëndin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë, si edhe procedurat e detajuara të pjesëmarrjes dhe të votimit, informacion mbi vëndin dhe mënyra e marrjes së dokumentacionit dhe projektvendimeve të asamblese si edhe elementët e tjera të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

11.8 Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbledhur rregullisht edhe nëse nuk ka ndjekur të gjitha formalitetet e thirrjes, nëse të gjithë Ortakët që përfaqësojnë pjesën e tërë kapitalit të shoqërisë janë të pranishëm në mbledhje apo të përfaqësuar nga një përfaqësues me prokure të posaçme, dhe shprehen dakort për të zhvilluar mbledhjen e asamblesë pavarësisht parregullsive në thirrjen e saj.

11.9 Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet edhe me pjesëmarrjen e njerëzve në vënde të ndryshme, dhe mund të mbahet përmes telekonferencës apo videokonferencës, ose mjete të tjera të ngjashme elektronike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'i jepet mundësia për të marrë pjesë në diskutimet dhe për të marrë pjesë në to.

11.10 Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga Kryetari i cili emërohet nga radhët e Ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje. Nëse prezenca e një noteri publik nuk është e nevojshme, Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një sekretar, i cili nuk duhet të jetë domosdoshmërisht një nga Ortakët.

11.11 Kryetari i Mbledhjes ka kompetenca të plota për të kontrolluar prokurat e posaçme dhe rregullsinë e tyre, të drejtën e Ortakeve dhe përfaqesuesve të tyre për të marrë pjesë në Asambleshë e Përgjithshme, si dhe për të përcaktuar nëse Mbledhja është thirrur rregullisht dhe nëse kuorumi i nevojshëm për marrjen e Vendimeve të vlefshme është arritur. Kryetari ka gjithashtu të drejtën për të drejtuar diskutimet dhe për të përcaktuar metodat dhe procedurat e votimit.

11.12 Në rast se Shoqëria ka vetëm një Ortak që ka fituar Kuotat e Ortakeve të tjerë me anë të një procesi ligjor dhe zotëron tërë kapitalin e shoqërisë, vendimet e Ortakut të vetëm do të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen.

## NENI 12

### **Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

12.1 Në rast vendimesh të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ortakët e shoqërisë që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të Kuotave me të drejtë vote. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit në thirrjen e parë, asambleja mund të mbledhet përsëri me të njëjtin rend dite brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas thirrjes së parë. Vendimet e zakonshme merren me votën pro të shumicës së ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar.

12.2 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të zakonshme mbi çështjet e mëposhtme:

- (a) përcaktimin e politikave tregtare;
- (b) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- (c) emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve;
- (d) miratimin e shpërblimeve për personat e përmendur në paragrafët (b) dhe (c);
- (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- (f) monitormin dhe mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratori;
- (g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në proceset gjyqësore ndaj Administratorit;
- (h) çdo çështje tjetër të përcaktuar nga ligji apo statuti.

12.3 Në rast vendimesh të jashtëzakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kuotave me të drejtë vote. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit në thirrjen e parë, asambleja mund të mbledhet përsëri me të njëjtin rend dite brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas thirrjes së parë. Vendimet e jashtëzakonshme merren me votën pro të të paktën  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar.

12.4 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të jashtëzakonshme mbi çështjet e mëposhtme:

- (a) ndryshimi apo plotësimi i Statutit të Shoqërisë;
- (b) zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit
- (c) shpërndarjen e fitimeve vjetore të dividendëve dhe akordimin e aksioneve në vënd të dividendëve;
- (d) riorganizimin, shpërndarjen, transformimin, bashkimin, shkriren, ndarjen, likuidimin apo prishjen e shoqërisë si edhe riorganizimin e shoqërisë në një formë tjetër;
- (e) ndërmarrjen e çdo veprimi i cili pritet në mënyr të arsyeshme se do të çojë në likuidimin e shoqërisë;
- (f) hapjen e një dege, blerjen apo shitjen e një dege me ose pa emer;
- (g) marrjen përsipër të çdo detyrimi me një vlerë më të lartë se 5% (pesë për qind) të aktiveve totale të shoqërisë siç rezultojn nga pasqyrat e fundit financiare të audituara.

## NENI 13

### **Administratori**

13.1 Asambleja e Përgjithshme do të caktojë një 1 (një) person fizik si Administrator të shoqërisë, i cili mund të jetë ortak ose jo dhe që do të jetë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë sipas kufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi dhe me këtë Statut.

Administratori ushtron këto detyra:

- (a) menaxhon shoqërinë duke zbatuar politikën siç përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme;

- (b) sigurohet që të mbahen librat dhe dokumentet e nevojshme kontabel;
- (c) Mban dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë dhe ja paraqet atë Asamblesë së Përgjithshme për miratim së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- (d) krijon një sistem paralajmërimi të hershëm në lidhje me zhvillimet që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- (e) paraqet të dhënat e shoqërisë për t'u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas rastit;
- (f) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për punën e Shoqërisë;
- (g) çdo detyrë tjetër siç përcaktohet me ligj ose Statut.

13.2 Administratori emërohet për një periudhë deri në 5 (pesë) vite dhe me të drejtë rizgjedhjeje. Ky emërim prodhon efekte ligjore në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

13.3 Shoqëria merr angazhime me nënshkrimin e vetëm të administratorit, sipas kufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi dhe në këtë Statut dhe Akt Themelimi.

13.4 Administratori i shoqërisë ka të drejtën dhe detyrimin për të përfaqësuar Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët.

13.5 Asambleja e Përgjithshme emëron si Administrator të shoqërisë, **Z. Alfred ÇARERI**, atësia Thanas, amësia Androniqi, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 13/10/1968, lindur në Tiranë dhe banues në adresën: Rruga: "Brigada e VIII" pall. 19, Hyrja 3, ap. 10, Njësia administrative nr 10-Tiranë, gjëndja civile "martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i dokumentit të identifikimit ID G81013097W, për një afat 5 (pesë) vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

## **TITULLI V VITI FINANCIAR, DIVIDENTI**

### **NENI 14 Viti Financiar**

14.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

14.2 Përfundimisht viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) dhe përfundon më 31 Dhjetor të atij viti.

### **NENI 15 Dividentet dhe Kapitalizimi i Fitimeve**

15.1 Përmes vendimit të asamblesë së përgjithshme shoqëria shpërndan dividentin në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve, nëse:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimin e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të paguar detyrimet që duhet të jenë të pagueshme brenda 12 muajsh.

15.2 Kapitalizimi i Fitimeve. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe në lidhje me parimet e përcaktuara në nenin 14, të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 i ndryshuar, Ligj nr. 129/2014, administratori mund të vendosë për të kapitalizuar fitimet.

## **TITULLI VI SHPËRBËRJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI**

### **NENI 16 Prishja-Ndarja-Bashkimi**

16.1 Shoqëria mund të prishet për shkaqet e parashikuara me ligj. Në rast të prishjes, Asambleja e zakonshme e Ortakëve emëron një ose me shumë likuidatore duke u përcaktuar kompetencat reciproke.

16.2 Shoqëria gjithashtu mund të ndahet ose të bashkohet me anë të një vendimi të asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve.

## NENI 17

### Likuidimi

17.1 Në rast të prishjes shoqëria mund të likuidohet.

17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Zakonshme e Ortakëve emëron një ose më shumë likuidatore i cili do të hartojë raportin përfundimtar mbi aktivet dhe pasivet e shoqërisë, si dhe procedurat dhe kohën e duhur për likuidim.

17.3 Në fund të procedurave të likuidimit, Asambleja e Zakonshme e Ortakëve do të vendosë në lidhje me bilancin përfundimtar, punën e bërë nga likuiduesi dhe të përfundojë procesin e likuidimit.

17.4 Me likuidimin e kreditorëve likuiduesit gjithashtu do të shpërndajnë aktivet e mbetura të Ortakëve në proporcion me përqindjen që ata disponojnë.

## TITULLI VII TË NDRYSHME

## NENI 18

### Gjuha dhe Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Çdo mosmarreveshje ose mosmarrëveshjet ndërmjet ortakëve ose në mes tyre në Shoqëri fillimisht do të zgjidhet në mënyrë të brendshme dhe miqësisht. Nëse, një zgjidhje miqësore nuk mund të arrihet brenda 60 ditësh, çështja do t'i referohet Gjykatave të Sarandës, me një proces të rregullt që do të zhvillohet në Shqipëri.


## DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Bazuar në vullnetin e lirë e të plotë si dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, nënshkruhet në gjuhën shqipe 3 (tre) ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “**METOQ AGROVOLTAIK**”-sh.p.k, në adresën: **Metok, zona kadastrale 2677, N. pasurie: 2/6/21 Metok-SARANDË** dhe Administrator **z. Alfred ÇARERI**

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“METOQ AGROVOLTAIK”- SHPK**

**Alfred ÇARERI**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Alfred Çareri', with a large, stylized flourish underneath.